

Albanian American Islamic Center of Arizona
“Greenway Masjid”

Dersi I Xhumase mbajtur nga Ylber Fetahu (antare i Bordit te Xhamise)

Djetor, 2007

Jeta e Amshuar

Elhamdu-lil-lahi rab-bilalemin ves-alatu
Ves-selamu ala muham-medin ve ala alihi ve sabihi exhmein

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botërave. Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit! Sunduesit në ditën e Gjykimit. Vetë Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë. Udhëzoni për në rrugën e drejtë? Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, e jo në të atyre që je i hidhëruar dhe që kanë humbur!

Transmetohet nga Ibn Omeri se i derguari I All-llahut ka thënë: Te jesh në këte bote si i huaj ose udhetar.

Njeriu jeton në këte bote aq sa ja ka caktuar Allahu te jetoje. Me pas është patjetër një ditë që vdes. Allahu I Madherueshem në Kuranin famelartë thotë: “*SECILI NJERI DO TA SHIJOJE VDEKJEN*” (Ali Imran:185)

Po ashtu thotë: “*TI DO TE JESHE I VDEKUR POR EDHE ATA DO TE JENE TE VDEKUR*” (Ez-Zumer.30).

Njeriu nuk e di se kur I perfundon jeta e tij dhe I vjen vdekja. Allahu I Madherueshem thotë: “*NUK E DI ASKUSH POS TIJ SE CKA DO TI NDODHE NESER, DHE ASKUSH NUK E DI, POS TIJ, SE NE C’VEND DO TE VDES. ALLAHU ESHTË ME I DIJSHMI, ME I NJOHURI.*” (LLukman;34).

Kjo bote është e perkohshme pa marrë parasysh se sa do zgjase jeta e njeriut në të. Ky është një realitet që shihet. E shohim çdo ditë dhe çdo natë si dhe e vërejmë çdo orë dhe çdo moment me pas vjen jeta e perjetshme dhe e pa fund. Allahu i Madherueshem do ngjall të gjithë njerezit prej varreve të tyre dhe do i grumbullojë në një vend për të llogaritur veprat e tyre dhe në fund

do gjykoje mes tyre, ose per ne Xhennet, gjersia e seciles eshte aq sa ka hapsire mes qiejve dhe tokes, e pregaditur per njerzit e devotshem, ose per ne Xhehnm, lende djegese e se ciles jane njerzit dhe guret, e pregaditur per jo besimtare nga I cili nuk ka dalje.

Besimtar i mencur eshte ai qe nuk mashtrohet me kete bote, dhe qe as nuk mendon se kjo eshte cdo gje. Ky besimtar, dashurine per kete bote e ka te vogel dhe e llogarit ate si are, ne te cilen ai mbjell veprat e mira per ti korrur frutet e tyre ne Ahiret, si dhe e merr ate si mbulese per te shpetuar ne uren e shtruar mbi xhehnm.

Per kete realitet kan folur te gjithe Pejgamberet. Ne Kuran shkruhet: *“O POPULLI IM ,KJO JETE E KESAJ BOTE NUK ESHTJE TJETER VETEM SE NJE PERJETIM I PERKOHSHEM ,NDERSA BOTA TJETER ESHTJE AJO E PERHERSHMJA.(Gafir:39)*

Besimtari ne kete bote duhet te jete si udhetari. Ai nuk qetesohet ne te e as nuk mashtrohet me stolit saja. Kjo bote nuk meriton qe njeriu te lidhet per te. sepse eshte nje bote kalimtare e jo e perjeteshme.

Besimtari I vertete duhet qe gjithmon ne zemren e tij te kete bindje se ne kete bote eshte duke jetuar si udhetari qe eshte larg nga familja dhe femijt e tij. Njeriu i tille eshte i permalluar per vendlindjen e tij dhe per familjen e tij. Sado qe te qendroje ai larg shtepise se tij, perseri ai nuk eshte i qete ne ate vend dhe se mendon ghithnje per momentin kur do te largohet nga ai vend e te kthehet ne familjen e tij .Keshtu edhe besimtari heq dore nga kenaqesit e kesaj bote, ngase kjo bote nuk eshte vendbanim i perjetshem.

Allahu I Madherishem thote: *“KJO JETE E KESAJ BOTE NUK ESHTJE TJETER VETEM SE NJE PERJETIM I PERKOHSHEM, NDERSA BOTA TJETER ESHTJE AJO E PERHERSHMJA.” (Gafir:39)*

Ibn Rexhebi ka thane: “Kur Allahu krijoi Ademin dhe gruan e tij ,ata I vendosi ne Xhennet mandej i nxjerri nga ajo. Njerzve te mire nga pasardhesit e tyre u eshte premtuar se do kthehen ne te. Pra besimtari gjithnje eshte i permalluar qe te kthehet ne vendlindjen e tij te pare, ngase dashurija e vendlidjes eshte pjese e Imanit.

Qofte lavdija mbi Krijusin e gjithesise. Salatet dhe Selamet qofshin mbi Muhamedin (a.s.) shokeve te tij dhe atyre te cileve i permbahen rruges se tij.

O Zot, fuqine tende ne nuk mund ta parafytyrojme.

O Zot, na fal gabimet tona dhe na mbro. Pranoji ibadetet tona dhe na e fal Xhennetin. Na shpeto nga zjarri i Xhehnemit.

O Zot, na ndihmo qe te adhurojme me nje adhurim te regullt.

O Zot, na i rregullo veprat tona, na mbro nga demoralizimet e kesaj bote si dhe nga denimet e ahiretit.

O Zot, na udhezo per ne Xhennet dhe na mbro nga zjarri i Xhehnemit.

O Zot, na i fal mekatet dhe na bej te lumtur. Na jep fuqi dhe force per ibadet. Na i ploteso nevojat qe kemi per Ty o Meshiruesi i Meshiruesve.

O Zot, na jep te mirat e kesaj bote si dhe ne boten e ardheshme.

O Zot, fali te gjith besimtaret ne Diten e Gjykimit.

Qofshin Salatet dhe selamet mbi gjithe Pejgamberet, dhe falimderimi i takon vetem Zotit te gjithesise.